Shkalla e inkasimit- institucionet	100%	46%	74%	26%	870%	131%	70%			
Total shpenzimet	(205,518)	(63,338)	(66,293)	(66,153)	(80,577)	(66,152)	(261,936)			
Mbetja + / -	56,593	(17,893)	(24,814)	(24,705)	21,595	(8,478)	(75,890)			

7. Shpenzimet operative – 2021

Tabela nr 15 - Shpenzimet operative

Shpenzimet sipas grupeve	Planifikimi- 2021	Faktike janar- dhjetor 2021						% e realizimit	
		TM1	TM2	TM3	TM4-2020	TM4	Faktike I-IX		Diferenca TM4-2020/ TM4-2021
Vlera furnizuese e materialit	792,276	152,494	191,113	202,353	192,604	188,467	734,428	(57,848)	93%
Shpenzimet e energjisë	2,506,793	535,065	559,363	572,005	571,096	560,720	2,227,153	(279,640)	89%
Shpenzimet e karburantëve	139,021	20,698	26,535	38,400	21,235	34,797	120,430	(18,591)	87%
Shpenzimet e personelit	5,613,917	1,398,136	1,332,058	1,422,636	1,720,071	1,399,349	5,552,179	(61,738)	99%
Shpenzimet materiale	700,464	114,824	101,484	195,723	213,753	148,020	560,051	(140,413)	80%
Shpenzimet e jashtme kontraktuese	707,530	160,476	330,331	170,109	341,230	928,614	1,589,530	882,000	225%
Shpenzimet e ndihmave solidarë	8,518	1,206	635	-	2,228	3,252	5,093	(3,425)	60%
Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimit	129,234	39,149	62,845	42,271	50,933	36,025	180,291	(14,908)	140%
Të dalurat financiare dhe transferi rezultatit financiar	26,647	2,417	2,076	1,358	52,142	4,621	10,472	(16,175)	39%
Gjithsejt shpenzimet operative	10,624,400	2,424,465	2,606,440	2,644,856	3,165,292	3,303,866	10,979,627	355,227	103%

Transaksionet me të mëdha gjatë vitit 2021

Tabela nr 15a –

Ministria e ekonomise dhe financa-KFW	1,339,478
ATK denimi (2014-2017)	2,123,446
Keds	557,158
Iber - Lepenc	224,399
AUTORITETI PËRMBARUES " ALEA " SH.P.K.	91,482
Muratori-nnp	28,525
EJONA SH.P.K.	59,357
InfraPlus SH.P.K	67,114
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor	54,274
P.T.K-VALA	46,596
ARRU-ZRRUK-Autoriteti Rregullato per sherb. e ujit	36,683

8. Raporti i Drejtorisë Komercial

Drejtoria Komerciale sipas skemës organizative është e ndarë në dy Departamente:

8.1 Departamenti Komercial

Departamenti Komercial kryen detyra të parapara me rregullore dhe ligje përkatëse për shërbime ndaj konsumatorit. Si detyrë primare ka shërbimet e faturimit dhe arkëtimit të mjeteve financiare. Shërbimi i Faturimit kryhet në bazë të rregulloreve të KRUP mbi faturimin e shërbimeve të Ujit "Rregullorja nr.05/2017 për matjen e shfrytëzimit të ujit si dhe shërbimeve tjera siç është kanalizimi, tarifa fikse, dhe shërbime tjera". Rregulloret e KRUP-së për faturim janë bazuar në Ligjin nr.05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit.

Siç dihet edhe në vitin 2021 kemi qenë pothuaj gjatë tërë kohës të ndikuar nga masat e parapara për mbrojtje nga epidemia e virus Covid 19, gjë që ka shkaktuar pengesa të vazhdueshme në realizimin e detyrave të punës në teren.

Nga tabela e mëposhtme shihet se rezultatet e arritura në faturim dhe inkasim duke pasur parasysh pengesat e përmendura, janë të përafërta me vlerat e parashikuara në buxhetin e vitit 2021, duke pasur parasysh se në tërësi brenda vitit janë arritur qëllimet për vitin 2021.

Në vazhdim po japim vlerat për indikatorët kryesor të matshëm për shërbimet e dhëna në periudhën e Raportimit TM4.

Tabela nr 16 - Raportimi mbi shërbimet e faturimit për periudhën 2021

Raportimi mbi shërbimet e faturimit për periudhën 2021						
Shërbimet Bazike	Nënloji\Muaji	TM1	TM2	TM3	TM4	2021
	Vlera Totale e Faturuar ME-TVSH pas Permirsimeve	3,668,771	3,842,628	4,052,773	3,972,060	15,536,232
	Inkasimi Total në Faturim ME-TVSH	3,517,465	3,270,969	3,571,669	3,758,886	14,118,989
	Shitjet Tjera (Uje Me shumice, shërbime tjera) Me tvsh	40,137	38,554	53,864	40,516	173,071
	Pagesat Nga Shitjet tjera me Tvsh	24,750	39,171	66,496	16,920	147,337
	Shitjet Total me tvsh	3,708,908	3,881,182	4,106,637	4,012,576	15,709,303
	Pagesat Total me Tvsh	3,542,215	3,310,140	3,638,165	3,775,806	14,266,326
	Total numri i Konsumatorve që kanë kryer pagesa gjatë periudhës	136,617	132,401	143,201	139,180	551,399
	% Inkasim\Faturim	96%	85%	89%	94%	90.8%
	Sasim m3 e faturuar	5,488,067	5,764,773	6,139,712	5,992,172	23,384,724
	Numri i faturave të dërguara	447,424	451,617	456,877	462,885	1,818,803
	Numri i Konsumatorëve të rinj	1,131	1,563	1,811	1,959	6,464
Shërbime tjera	Numri i përmirësimeve - largimeve sipas proceseve	968	284	185	239	1,676
	Numri total i konsumatorëve pasiv (nuk dërgohen fatura)	14,832	14,832	14,440	14,456	58,560
	Numri total i konsumatorëve me tarife fikse	4,516	4,509	4,494	4,639	18,158
	Numri i leximeve me zero sasi të harxhimit	128,625	128,452	117,650	128,807	503,534
	Numri i leximeve me fotografi nga lexuesit në sistem	28,026	28,780	-	38,826	95,632
	Numri komenteve të dërguara nga lexuesit në sistem	28,026	28,780	-	38,826	95,632
	Numri i faturave të konsumatorëve që nuk gjenden?	1,830	1,830	1,830	1,830	7,320
	Nr. Vërejtjeve të krijuara për konsumatorët	12,841	12,429	16,946	17,435	59,651
	Numri i zëvendësimeve të Ujëmatësve	785	544	569	566	2,464

Numri i faturave qe anulohen gjate muajit	350	350	130	1,428	2,258
---	-----	-----	-----	-------	-------

Duhet të ceket se gjatë periudhës së fundit të raportimi TM4 kur edhe bëhet mbyllja e vitit është punuar më shumë në dërgimin e vërejtjeve tek konsumatorët, ku shihet edhe rritje e numrit të vërejtjeve, si dhe ka pasur rritje në regjistrimin e konsumatorëve të rinjë.

Gjatë tërë kohës është punuar me intenzitet të shtuar në të gjitha shërbimet, në mënyrë që të mbërrihen qëllimet e planifikuara.

Duhet cekur se Shërbimi i Leximit ende nuk është plotësuar me lexues të rinjë të cilët janë të parapara për plotësim të nevojave të shërbimit.

Në fund të vitit ka pasur edhe ndryshime në Organogramin e ri për vitin 2022 të cilat shpresojmë të sjellin përmirësime në shërbimet ndaj konsumatorit dhe një efikasitet më të madhe për vitin 2022

8.2 Departamenti për Kujdes ndaj Konsumatorit

Departamenti për Kujdes ndaj konsumatorit kryen detyra të parapara me rregullore dhe ligje përkatëse për shërbime ndaj konsumatorit. Detyrë kryesore e departamentit është përkujdesja ndaj konsumatorit, gjithmonë duke vënë në rend të parë kënaqshmërinë e konsumatorit me shërbimet e dhëna nga KRUP. Për këtë qëllim shërbimet brenda departamentit pranojnë kërkesa të ndryshme, ankesa dhe opinione rreth shërbimeve të dhëna. Përgjigje në të gjitha ankesat dhe kërkesat kryhet nga shërbimet e KRUP brenda afateve ligjore dhe “Rregullores së brendshme me numër 01/2017 për zgjedhjen e ankesave të konsumatorëve”. Drejtoria komerciale gjatë tërë kohës bënë planifikimet paraprake për kryerjen e detyrave në mënyrë efektive dhe brenda afateve të parapara.

Edhe në Departamentin për Kujdesje ndaj Konsumatorve është punuar rregullisht dhe pa probleme.

Secili shërbim brenda departamentit ka vepruar në përputhje me detyrat e dhëna dhe nga rezultatet e arriturat në bazë të secilit indikator shihet se ka pasur një rritje të nevojave dhe kërkesave nga Qytetarët.

Siç dihet edhe në vitin 2021 kemi qenë pothuaj gjatë tërë kohës të ndikuar nga masat e parapara për mbrojtje nga epidemia e virus Covid 19 , gjë që ka shkaktuar pengesa të vazhdueshme në realizimin e detyrave të punës.

Duke pasur parasysh se shërbimet me konsumator janë të ndieshme dhe me kontakte të drejtpërdrejta me konsumator, duhet të ceket se brenda departamentit janë marrë të gjitha masat e parapara ligjore për mbrojtje të konsumatorve dhe nuk kemi pasur ndonjë vërejtje në këtë drejtim.

Posaçërisht shihet një rritje e numrit të shërbimeve që ju ipen qytetarëve me shërbimin e Qendrës së thirrjeve (e cila siç e dimë është riorganizuar këtë vit), nga ku del se për një shërbim të tillë ka pasur nevojë edhe më parë. Gjithashtu shihet nevoja për rritje të stafit dhe mbulim të shërbimeve 24/7.

Në vazhdim po japim vlerat për indikatorët kryesor të matshëm për shërbimet e dhëna në periudhën e Raportimit TM4 dhe njëkohësisht bashkangjitur edhe vlerat për periudhat paraprake për vitin 2021.

Tabela nr 17 - Departamenti për Kujdesë ndaj Konsumatorit -Raporte të TM-ve gjatë periudhës 2021

Departamenti për Kujdesë ndaj Konsumatorit -Raporte të TM-ve gjatë periudhës 2021						
Lloji	Nën lloji	TM1	TM2	TM3	TM4	2021
Lajmërimet teknike të ankesave / kërkesave të regjistruara në CRM nga Qendra e Thirrjeve	N/A	5	4	1	4	14
	Bllokime të kanalizimit	1,001	1,032	1,014	912	3,959
	Rrjedhje – Plasaritje e gypit të ujit	690	762	1,079	737	3,268
	Dëmtimi i aseteve të ofruesit të shërbimeve /vërshimet në kanalizim	9	24	20	13	66
	Lajmërim i ndodhjeve me efekte teknike? kolapset në kanalizim	5	4	4	4	17
	Mos furnizim me ujë - mungesë e ujit	111	145	97	91	444

	Mos rehabilitimin e rrugës pas punimeve	5	14	17	15	51
	Jo vazhdimësi me ujë nga presioni ulët	25	48	35	43	151
	Cilësia e dobët e ujit - Shije dhe erë kundermuse	3	2	9	10	24
	Lajmërime teknike në totali	1,854	2,035	2,276	1,829	7,994
Komunikimet e ankes/ kërkesave Komercilae nga Qendra e Thirrjeve	Kartela financiare	249	184	209	271	913
	E-Bankign	68	60	153	169	450
	Mos pranim te faturës	26	23	48	37	134
	Regjistrim on-line	16	9	39	28	92
	Informatë për ri-programim	6	-	1	1	8
	Te ndryshme	243	295	498	671	1,707
	Komunikimet komerciale në total	608	571	948	1,177	3,304
Komunikimet, Facebook - Viber te pegjithshme nga Qendra e Thirrjeve	Facebook - Komunikimet	1,196	755	724	873	3,548
	Viber - Komunikimet	972	1,103	909	856	3,840
	Facebook- Viber, komunikimet në total	2,168	1,858	1,633	1,729	7,388
Pranimi i kërkes/anakesave Teknike te regjistruera në CRM nga Sherbimi per Konsumator	Kërkesa për Kushte teknike, kërkesë për informacion etj /DPZH	166	189	204	176	735
	Kërkesa për kyçe të shërbimeve individuale(për herë të parë) DSH	153	241	268	185	847
	Kërkesa për regjistrim -verifikim, bazhdarim, ndërrim të UM etj /SHU dhe DSH	278	236	321	215	1,050
	Kërkesa për mungesë të ujit apo shtypjes/DO	8	15	11	7	41
	Kërkesa për mirëmbajtje te rrjetit ,kanalizimit /DO	5	3	13	10	31
	Kërkes/ankesa teknike në total	610	684	817	593	2,704
Pranimi i kërkes/anakesave Komerciale te regjistruera në CRM nga Sherbimi per Konsumator	Kërkesë/ankesa për faturim, mos lexim te UM, pagesa, mos dërgim të faturave	372	368	416	334	1,490
	Kërkesa për ndërrimi të emrit te konsumatorit	395	344	441	443	1,623
	Kontratat për Ofrimin e Shërbimit për Konsumatorë	1,640	1,350	970	3,931	7,891
	Kontrata për ri programime	358	291	178	172	999
	Anulim I kontratës të ri programuar pas pagesës së borxhit te mbetur	15	10	14	29	68
	Kërkes/ankesa Komerciale në total	2,780	2,363	2,019	4,909	12,071
Shqyrtimi i kërkes/anakesave nga komisioni Vendime-Amvisri	Kërkesa te aprovuara	353	242	296	244	1,135
	Kërkesa te refuzuara	122	38	105	132	397
	Ankesa te aprovuara	-	26	17	9	52
	Ankesa te refuzuara	80	66	37	29	212
	Vendime -Amvisëri në total	555	372	455	414	1,796
Shqyrtimi i kërkes/anakesave nga komisioni Vendiem-Biznese	Kërkesa te aprovuara	49	47	40	98	234
	Kërkesa te refuzuara	13	9	13	22	57
	Ankesa te aprovuara	-	19	-	-	19
	Ankesa te refuzuara	-	2	5	16	23
	Vendime -Biznese në total	62	77	58	136	333
	Amvisëri numri i lendeve per pasivizim	80	43	75	75	273

Pasivizim i ujmatasave	Amvisëri numri i lendeve per refuzim	-	-	13	10	23
	Biznese numri i lendeve per pasivizim	-	-	20	2	22
	Biznese numri i lendeve per refuzim	11	4	3	7	25
	Pasivizime në total	91	47	111	94	343
Korrigjim borxheve Vendime	Amvisëri -raste	234	162	216	157	769
	Biznese -raste	24	22	25	66	137
	Korrigjime borxhi në total	258	184	241	223	906
Arkivimi lendeve	Lende te mbyllura në CRM	1,954	1,305	1,446	1,734	6,439
	Lende te skanuera e te rujtura ne kartoteken elektronike	1,832	761	1,186	3,055	6,834
	Lende te kompletuara e ngarkuara në CRM	1,715	395	1,256	3,010	6,376
	Arkivime / skanime në total	5,501	2,461	3,888	7,799	19,649
Bashkpunim me ARRU	Kërkesa per kompletim te landëve nga ARRU	30	53	49	47	179
	ARRU- shkembim te informatavwe në total	30	53	49	47	179

Departamenti Komercial kryen detyra të parapara me rregullore dhe ligje përkatëse për shërbime ndaj konsumatorit. Si detyrë primare ka shërbimet e faturimit dhe arkëtimit të mjeteve financiare. Shërbimi i Faturimit kryhet në bazë të rregulloreve të KRUP mbi faturimin e shërbimeve të Ujit "Rregullorja nr.05/2017 për matjen e shfrytëzimit të ujit si dhe shërbimeve tjera siç është kanalizimi , tarifa fikse, dhe shërbime tjera". Rregulloret e KRUP për faturim janë bazuar në Ligjin nr.05/L-042 për rregullimin e shërbimeve të ujit.

Siq dihet edhe ne vitin 2021 kemi qene pothuaj gjate tere kohës te ndikuar nga masat e parapara per mbrojtje nga epidemia e virus Covid 19 , gje qe ka shkaktuar pengesa te vazhdueshme ne realizimin e detyrave te punës ne teren.

Rezultatet

Nga tabela e mëposhtme shihet se rezultatet e arritura ne faturim dhe inkasim duke pasur parasysh pengesat e permenduara,janë te përafërta me vlerat e parashikuara ne buxhetin e vitit 2021, duke pasur parasysh se ne tërësi brenda vitin janë arritur qëllimet per vitin 2021.

Tabela nr 17 - Departamenti per Kujdesë ndaj Konsumatorit -Raporte te TM-ve gjatë periudhes 2021

<i>Emertimet</i>	<i>2021 plani</i>	<i>2021 reale</i>	<i>Indexi</i>
<i>Të hyrat nga shërbimi i furnizimit me ujë</i>	15,741,048	14,397,126	91%
<i>Arketimet nga shërbimi i furnizimit me ujë</i>	14,649,987	13,071,471	89%
<i>Nr. Konsumatorëve</i>	151,888	154,974	102%
<i>Sasia e faturuar m3</i>	49,594,948	55,175,048	111%

Ne vazhdim po japim vlerat per indikatorët kryesor te matshëm per shërbimet e dhëna ne periudhën e Raportimit TM4, dhe njëkohësisht bashkangjitur edhe vlerat per periudhat paraprake per vitin 2021.

Sfidat

Duhet te ceket se gjate periudhës se fundit te raportimi TM4 kur edhe behet mbyllja e vitit eshte punuar me shume ne dërgimin e vërejtjeve tek konsumatorët, ku shihet edhe rritje e numrit te vërejtjeve,si dhe ka pasur rritje ne regjistrimin e konsumatorve te rinje.

Gjate tere kohës eshte punuar me intenzitet te shtuar ne te gjitha shërbimet,ne menyre qe te mbërrihen qëllimet e planifikuara.

Duhet cekur se Shërbimi i Leximit ende nuk eshte plotësuar me lexues te rinje te cilete janë te parapare per plotësim te nevojave te shërbimit,duke pas parasysh se kemi pasur raste te vdekjes se lexuesve, pensionim,si dhe kemi lexues qe janë ne moshe dhe te paaftë per te kryer detyrat.

Ne fund te vitit ka pasur edhe ndryshime ne Organogramin e ri per vitin 2022 te cilat shpresojm te sjellin përmirësime ne shërbimet ndaj konsumatorit dhe nje efikasitet me te madhe per vitin 2022.

Departamenti për Kujdes ndaj konsumatorit kryen detyra të parapara me rregullore dhe ligje përkatëse për shërbime ndaj konsumatorit. Detyrë kryesore e departamentit është përkujdesja ndaj konsumatorit, gjithmonë duke vënë në rend të parë kënaqshmërinë e konsumatorit me shërbimet e dhëna nga KRUP. Për këtë qëllim shërbimet brenda departamentit pranojnë kërkesa të ndryshme, ankesa dhe opinione rreth shërbimeve të dhëna. Përgjigje në të gjitha ankesat dhe kërkesat kryhet nga shërbimet e KRUP brenda afateve ligjore dhe "Rregullores së brendshme me numër 01/2017 për zgjedhjen e ankesave të konsumatorëve". Drejtoria komerciale gjatë tërë kohës bënë planifikimet paraprake për kryerjen e detyrave në mënyrë efikase dhe brenda afateve të parapara.

Sfidat

Edhe ne Departamentin per Kujdesje ndaj Konsumatorve eshte punuar rregullisht dhe pa probleme. Secili shërbim brenda departamentit ka vepruar ne përputhje me detyrat e dhëna , dhe nga rezultatet e arritur ne baze te secilit indikator shihet se ka pasur nje rritje te nevojave dhe kërkesave nga qytetaret.

Siq dihet edhe ne vitin 2021 kemi qene pothuaj gjate tere kohës te ndikuar nga masat e parapara per mbrojtje nga epidemia e virus Covid 19 , gje qe ka shkaktuar pengesa te vazhdueshme ne realizimin e detyrave te punës.

Duke pasur parasysh se shërbimet me konsumator janë te ndieshme , dhe me kontakte te drejt per drejta me konsumator,duhet te cekët se brenda departamentit janë marre te gjitha masat e parapara ligjore per mbrojtje te konsumatorve , dhe nuk kemi pasur ndonjë vërejtje ne kete drejtim.

Posaqerishte shihet nje rritje e numrit te shërbimeve qe iu jepen qytetarve me shërbimin e Qendres se thirrjeve (E cila siq e dimë eshte riorganizuar kete vite), nga ku del se per nje shërbim te tille ka pasur nevojë edhe me pare.Gjithashtu shihet nevoja per rritje te Stafit dhe mbulim te shërbimeve 24/7.

Kemi probleme me plotësimin e disa vendeve te punës brenda shërbimeve te cilat duhet te plotësohen gjate periudhës ne vijim.

Planifikimi - 2022 per Drejtorin Komerciale

Siq e dimë KRUP ka nje plan te pergjitheshem afat mesëm dhe plan vjetor per realizimin e te gjithë parametrave te rendsishem ne kompani.

Perveq tyre, brenda Drejtorise Komerciale ,Departamenti Komercial dhe Departamenti i marrdhenieve me konsumator,ka plane afat shkurtera te cilat i kontrollohen ne afate mujore per realizimin e tyre.

Posaqerisht kontrollohen parametrat e faturimit, inkasimit, si dhe parametrat e brendshëm per realizimin e detyrave mujore.

Per kete qellim Drejtoria pergadit raporte mujore krahasimore me te dhëna ne te gjithë parametrat kryesor per secilin departament.

Ne menyre qe te arrihen qëllimet e departamenteve , per vitin 2022 Drejtoria Komerciale qe ne fillim te vitit 2022 do te beje veprime te duhura per përmirësime ne drejtime te ndryshme e ku edhe kane qene sfidat kryesore gjate vitit 2021.Posaqersihet do te merret me zgjedhjen e problemeve si:

1. Rritje te Faturimit
2. Rritje te inkasimit
3. Efikasitet te leximit dhe saktësi ne lexime
4. Komunikim me i dendur me ARRU, njësinë e ankesave dhe kërkesave.
5. Zgjedhja e problemit te leximeve te gabuara,ose edhe mos leximeve
6. Zgjedhje dhe plotësime te mungesave ne staf ,duke plotësuar me staf te ri nga jashtë, duke lëvizur stafin e brendshëm me konkurse te brendshme.
7. Kontroll me i madhe i papërgjegjësive tek disa te punësuar tek te cilët eshte vërejtur mos efikasitet dhe probleme ne kryerjen e detyrave.

9. Departamentet nën menaxhimin e Sekretarit të Ndërmarrjes

Zyra Ligjore ka procesuar të gjitha kërkesat të cilat i janë adresuar kësaj zyre duke u kujdesur për respektim të afatëve ligjore për të gjitha shkresat dhe parashtresat e pranuar. Në vijim paraqesim të dhënat e shprehura në statistika për të gjitha punët e kryera gjatë periudhës raportuese Tetor - Dhjetor 2021.

Tabela nr 18 - Rastet në procedurë gjyqësore – aktualisht në Gjykatën e Apelit

Nr.	Numri i inventarit të rastit	Pala paditëse	Valuta	Vlera e kontestit
1	C.nr.3881/18	Hamit Gashi (shpërblim jubilar)	€	2,564
2	C.nr.362/2019	Sh.R. (shpërblim jubilar)	€	2,422
3	C.nr.284/13	NT "Eliesa" sh.p.k. (kompensim dëmi)	€	12,819
4	C.nr.45/17	M.L. (kompensim dëmi)	€	3,100
5	C.nr.1028/16	Gj.V. (kontest pune)	€	24,440
6	C.nr.176/15	S.R. (kontest pune)	€	65,164
7	CN.nr.170/13	R.Sh. (shpronësim me servitut)	€	13,825
8	CN.nr.1282/17	R.Sh. (shpronësim me servitut)	€	20,000
9	76256/28.09.2021	Gjoha nga ATK	€	2,094,860.49
Totali			€	2,135,868.92

Procesi i Përmbartimit për periudhën: Tetor - Dhjetor 2021

1. Lëndë të dërguara në Përmbartim: 82
2. Vlera e pagesave në këtë periudhë: 35,331.53 €
3. Taksa të kthyera nga debitorët: 2,652.86 €
4. Lëndë të përfunduara: 63

Zyra Ligjore ka perditësuar të gjitha të dhënat e lëndëve përmbartimore në sistemin elektronik dhe njëkohësisht ndryshon/plotëson çdo të dhënë në kohë reale me ndryshimet statusore të lëndëve aktive në procedurë.

Po ashtu, në kuadër të aktiviteteve të Zyrës Ligjore janë kryer edhe punë të ndryshme administrative sipas kërkesës si: Caktimi në Komisione të ndryshme, mbajtja e kontaktit të vazhdueshëm me Përmbartuesit Privat në lidhje me debitorët, sqarimi i konsumatorëve të cilët kanë ardhur për konsulta në Zyren Ligjore për çështje të ndryshme si dhe përgjigja në shkresa të ndryshme.

9.1. Raporti nga Departamenti për Administratë të Përgjithshme

Tabela nr 18 - Shërbimi për Administratë Personel dhe Burime Njerëzore

Shërbimi për Administratë Personel dhe Burime Njerëzore			
Lloji i punës së kryer	sasia	Lloji i punës së kryer	sasia
Kontrata Pune	617	Formular për punëdhënësin kryesor	///
Aktvendim për mardhënje pune	20	Vendim për transferim	39
Pëlqime-Vendime për Pushim Vjetor	547	Aktvendim për caktim të nevojave për punëtor të ri	///
Vendime për Pushim pa pagese	8	Llogaria mujore për punëtorët e Shërbimit Juridik	12
Aktvendim për ndërprerje të mardh. Punë	3	Raporti javor i punës	///

Aktivendime për shkëputje të kontrates sipas fuqisë ligjore	13	Vendime – Aktivendime, Shkresa të ndryshme	119
Konkurse-procedurat	6	Skanimi i dosjeve	///
Procedura të rekrutimit-përzgjedhjeje	6	Raporte javore të punës	///
Procedura disiplinore	8	Raporte mujore të punës	///
Vendime për Pushim të lehonisë	2	Raporte vjetore të punës	///
Vendime për Pushim të Jashtëzakonshëm	34	Autorizime	4
Kontrata për punë dhe detyra specifike	3	Projekt menaxher i kontratave	///
Vërtetime-dëshmi për përvojën e punës	94	Njoftime	2
Dokumentacion për kredi	89	Praktikant - procedura	31

Brenda kësaj periudhe – 01.01.2021 – 31.12.2021 është kryer puna e arritur dhe e planifikuar në Shërbimin e Administratës dhe Personelit.

Është punuar edhe nga rasti në rast sipas kërkesave të menaxhmentit të Kompanisë, sipas kërkesave të punëtorëve të ndryshëm për çështje të ndryshme, të kandidatëve të ndryshëm pjesëmarrës nëpër konkurse si: për punë profesionale, çasje në dosje personale për nevoja të ndryshme dhe plotësim të dokumentacioneve për nevoja të ndryshme e të paspecifikuara.

Brenda kësaj periudhe nuk mund të specifikohet ndonjë rast për të cilin është dashur të kryhet e ka mbetur pa përfunduar, apo ndonjë punë të zvarritet dhe nuk është kry.

Shërbimi i Arkives

Për vitin 2021 nga Shërbimi i Arkives raporti është si vijon:

Janë Protokoluar 2018 dokumenta dhe po ashtu janë bërë edhe Ekspedicionet në vend për 2018 dokumenta;

Janë scanuar 1194 dokumenta.

Shërbimi i Sigurimit fizik të Objekteve

Mandati i Shërbimit të Sigurimit të KRU "Prishtina" Sh.A.

Në bazë të Rregullores mbi organizimin, sistematizimin dhe funksionimin e shërbimit të sigurisë si dhe në bazë të detyrave të punës të përcaktuara me ligj, udhëzime administrative dhe kontrates së punës, shefi i këtij shërbimi ka bërë inspektimin dhe evaluimin apo vlerësimin e gjendjes së sigurisë në të gjitha objektet dhe premiset e KRU "Prishtina" Sh.A. Për herë të parë kemi Inspektuar Objektet dhe premiset në të gjitha regjionet e KRU – "Prishtina". Ky inspektim ka zgjatur dy muaj. Të gjeturat dhe rekomandimet individuale janë në aneks të këtij raporti dhe të dhënat nga ky inspektim janë konfidenciale.

Mënyra e punës

Inspektimi i sistemit të sigurimit të KRU "Prishtina" Sh.A. është bërë nga shefi i këtij shërbimi. Inspektimi është bërë në pajtim me standartet europiane dhe ndërkombëtare të përgaditura paraprakisht dhe në pajtim me standartet e sigurimit për të pasqyruar sa më realisht gjendjen ekzistuese të sigurisë në kompleksin e objekteve të KRU "Prishtina" Sh.A. Një pjesë të informatave i kemi marr nga zyrtaret dhe personeli të cilët punojnë në kampuset dhe objektet e KRUP-së.

Gjatë inspektimit kemi gjeneruar materialet e poshtëshënuara siç janë:

Lista kontrolluese (veçmas për çdo objekt);

II. Materialet me të cilat disponon KRU "Prishtina" Sh.A. të përpiluara nga shefi i sigurimit, të cilat janë në plotni në dakordancë me standartet europiane:

Rregullat e Përgjithshme për Roje – Procedurat Standarde të Operimit;

Rregullorja për sigurim fizik dhe teknik;
Rregullorja për mbrojtje kundër zjarrit (kjo rregullore i është dorëzuar zyrtarit për mbrojtje në punë);
Rregulloren përgjegjësitë disiplinore dhe material (në kuadër të tërë ndërmarrjes);

Këto rregullore i janë dorëzuar Sekretarit të KRUP-së për t'i krahasuar dhe harmonizuar me ligjet pozitive të cilat e rregullojnë këtë materie.

Struktura e raportit

Raporti përbëhet prej këtyre pjesëve:

Hyrje;

Rregullimi normativ i sistemit të sigurimit të KRU "Prishtina" Sh.A.;

Rrethanat, faktet dhe dukuritë, të cilat sipas vlerësimit të shërbimit të sigurimit ndikojnë në organizimin dhe funksionimin e sistemit të sigurisë të KRU "Prishtina" Sh.A.;

Funksionimi i sistemit;

Konstatimet themelore të udheheqesve të shërbimit të sigurimit;

Rekomandim masat.

Gjatë inspektimit në përgjithësi i tërë personeli i KRU "Prishtina" Sh.A. është treguar i gatshëm për bashkëpunim dhe ka ofruar të gjithë dokumentacionin që posedojnë si dhe informatat e kërkuara nga shërbimi i sigurimit për çka i falenderoj.

Rregullimi normativ i sistemit të sigurimit të KRU "Prishtina" Sh.A.

Për identifikimin e sistemit të sigurimit është i domosdoshëm ballafaqimi me dy pyetje themelore: E para, cili organ sipas ligjit dhe rregulloreve në fuqi është kompetent (d.m.th. përgjegjës dhe i obliguar) të kryejë punët e caktuara të sigurimit. Pastaj, cilat janë masat, autorizimet dhe detyrat e punëtorëve të sigurimit, të cilat janë përcaktuar dhe që përbëjnë sistemin e sigurimit.

Përgjigjja në pyetjen e parë është se në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji Nr. 04/L-004 Për Shërbimet Private të Sigurisë, i cili rregullon të gjitha aktivitetet në fushën e sigurisë private dhe i cili ka filluar se zbatuari prej datës 08.07.2011.

Në nenin 3 të këtij ligji taksativisht përcaktohet se "Shërbimet e sigurimit ofrohen vetëm nga kompanitë private të sigurimit, të licencuara dhe të autorizuar në pajtim me këtë ligj.

Shërbimet e sigurimit ushtrohen vetëm përmes punëtorëve të licencuar të sigurimit në pajtim me këtë ligj."

Në kuadër të këtyre pyetjeve ndahen dy qështje shumë të rëndësishme:

Çfarë është struktura organizative, brenda së cilës realizohet, funksionon sistemi i sigurimit dhe personat të cilët kanë autorizime të veqanta dhe përgjegjësi, lidhur me sistemin e sigurimit; dhe Cila është baza rregullative dhe normative për organizimin dhe funksionimin e këtij sistemi të sigurimit brenda KRU "Prishtina" Sh.A.

KRU "Prishtina" Sh.A., ka të përcaktuara, përpiluara dhe të aprovuara Politikat e përgjithshme për sigurim dhe mbrojtje kundër zjarrit;

Shërbimi i sigurimit të KRU "PRISHTINA" Sh.A., ka të përcaktuara, përpiluara, aprovuara dhe të implementuara:

Rregullat e Përgjithshme për Roje – Procedurat Standarde të Operimit;

Rregulloren për sigurim fizik dhe teknik;

Rregulloren për mbrojtje kundër zjarrit;

Rregulloren disiplinore (në kuadër të tërë ndërmarrjes);

Ndërsa, nuk ka të përcaktuar, përpiluar dhe të aprovuar:

Rregulloren e komunikimit;

f) Frekuencën e veqante për radiokomunikim vetëm për shërbim të sigurimit etj.

Këto rregullore janë harmonizuar me Ligjin 04/L-004 për Sherbimet Private të Sigurisë dhe Udhëzimet Administrative të MPB-së, të cilat shërbejnë për zbatimin me të detajuar të këtij ligji dhe të cilat në masë të madhe e rregullojnë këtë segment të sigurisë. Në zbatimin e detyrave përparësi ka ligji dhe aktet nenligjore, andaj çdo keqinterpretim i masave, autorizimeve dhe detyrave të cilat janë të rregulluara me rregullore të brendshme, para se ligji të hynte në fuqi ose shpallen të pavlefshme ose harmonizohen me legjislacionin në fuqi. Në ndërkohë është aprovu Ligji për Infrastrukturë Kritike (Ligjin nr.06/L-014, 30/ mars/ 2018, hynë në fuqi 1 vit pas publikimit në Gazetën Zyrtare të RKS). (Neni 5 pika 2.11 Furnizimi me ujë dhe ujërat e zeza (furnizimi, rezervuarët dhe digat). Qellimi i këtij Ligji është për të ruajtur dhe mbrojtur infrastrukturen kritike kombëtare dhe evropiane, për të mbrojtur qytetet e Republikës së Kosovës, parandaluar incidentet dhe minimizuar demin potencial për infrastrukturen kritike, pasurinë e përgjithshme, humbjet ekonomike dhe sociale, siguruar stabilitetin e qeverisë dhe rritur qendrueshmerinë.

Gjatë vitit 2019 janë bërë ndryshime në Ligjin 04/L-004 për Sherbimet Private të Sigurisë, me ç'rast është përpiluar projektligji për Sherbimet Private të Sigurisë i cili lejon Sigurimin e mbrendshëm dhe sigurimin e infrastruktures kritike (sidomos kjo e fundit duhet të organizojë sigurim të armatosur). Në këtë çështje përkundër shumë insistimeve dhe rekomandimeve nga shefi i sigurimit për të përgaditur infrastrukturen e nevojshme për t'u licensuar për këtë shërbim, menaxhmenti i KRUP-it, nuk kishin buxhet për ta kryer këtë proces, që d.m.th. nuk e kemi përgaditur Ndërrmarjen për ta ofruar këtë shërbim.

- Listat e aksesit kontrollit (hyrje-daljeve) të punëtorëve gjatë dhe pas orarit zyrtar (të regullte) të punës. Ndëj obligim ta elaboroj dhe sqaroj rregullimin normativ të evidencës të lartëshënuar.
- Formulari është përpiluar në pajtim dhe dakordance me Ligjin për mbrojtjen e të dhënave Personale Ligji Nr. 03/L-172, po ashtu me nenin 69 paragrafi 2.

- Ndërsa, të gjitha regjistrimet të cilat merren duhet të përpilohen në pajtim të plotë me nenin 61 (nen-kreu-J vëzhgimi me kamera), Neni 62, Neni 63, Neni 64, (Nen kreu-K Përdorimi i karakteristikave Biometrike), Neni 65, Neni 66, Neni 67 dhe nen kreu-L (regjistrimet e hyrjes dhe daljes nga ndërtesat). Duhet theksuar se përdorimi i këtyre pajisjeve mund të bëhet vetëm në raste kur domosdoshmërisht kërkohet për sigurinë e njerëzve dhe sigurinë e pronës.

Të gjitha veprimet procedurale, operative dhe taktike të punëtorëve të sigurimit kryhen në bazë të Ligjit nr. 04/L-004 dhe me detajisht me udhëzimin administrativ UA nr.30/2011 – MPB për masat, autorizimet dhe detyrat e punëtorëve të sigurimit, me konkretisht me nenin 3 të këtij udhëzimi përcaktohen masat autorizimet dhe detyrat e punëtorëve të sigurisë private.

1. Masat, autorizimet dhe detyrat e punëtorëve të sigurisë private janë si në vijim:

- 1.1. identifikimi i personit para hyrjes/daljes nga hapësira e siguruar, kur është e domosdoshme, për sigurinë e personave dhe pasurive të ruajtura;
- 1.2. paralajmëron personin të lëshojë zonën, ndërtesën ose hapësirën e ruajtur nëse personi hyn pa autorizim;
- 1.3. kontrolli i personit me prekje, valixheve dhe kontrollimi i brendshëm i automjetit para hyrjes/daljes nga hapësira e siguruar, nëse personi pajtohet;
- 1.4. ndalon hyrjen/daljen e personit nga hapësira e siguruar nëse personi kundërshton kontrollin, refuzon të tregojë identitetin ose kur ekzistojnë arsye të tjera për ndalimin e hyrjes/daljes nga hapësira e siguruar;
- 1.5. kërkon nga personi i cili rrezikon sigurinë e personave apo pasurive ose vepron në kundërshtim me rregullat e hapësirës së siguruar që menjëherë të ndalojë veprimin.
- 1.6. ndalon personin i cili është kapur duke kryer veprim të paligjshëm deri në ardhjen e policisë;
- 1.7. përdorë pranga nëse personi nuk mund të ndalohet ndryshe;
- 1.8. përdorë forcën fizike në hapësirën e siguruar, nëse në mënyrë tjetër nuk mund të parandalohet, rrezikimi i drejtpërdrejtë i jetës së njerëzve dhe pronës së siguruar;
- 1.9. përdorimin e sistemeve të mbikëqyrjes me video dhe mbajtja e evidencës së vizitorëve në hapësirën e siguruar.

Në bazë të kësaj konstatojmë se rregullativa që mundëson organizimin dhe funksionimin e sistemit të sigurimit brenda KRU "Prishtina" është në nivel të kënaqshëm. Rrethanat, faktet dhe dukuritë, të cilat sipas vlerësimit të Sherbimit të Sigurimit ndikojnë në organizimin dhe funksionimin e sistemit të sigurimit të KRU "Prishtina" Sh.A.

Sipas vlerësimit të Sherbimit të Sigurimit në organizimin dhe funksionimin efektiv të sistemit të sigurimit të KRU "Prishtina" Sh.A., përveq rregullimit normativ që paraqet bazën për veprim ndikojnë edhe këta faktorë:

Infrastruktura e dëmtuar (perimetri-rrethojat e dëmtuara, portat, ndriqimi i jashtëm, ndriqimi i brendshëm, dyert dhe dritaret), mungesa në masë e pajimeve për komunikim të brendshëm, mungesa e sistemeve të alarmeve kundër vjedhjes, (përveç në Drejtori ku është instaluar sistemi i alarmit kundër zjarrit dhe në Fabriken e Ujit në Badovc), mungesa e sistemeve të TV-ve të qarkut të mbyllur (përveç në Drejtori dhe Albanik ku janë instaluar dy sisteme me vërejtje nga Sherbimi i sigurimit), mungesa e pajimeve për akses kontrolle (përveç në Drejtori), mungesa e arkave për sigurim të dokumentacionit, qelsave dhe mjeteve të konfiskuara nga shërbimi i sigurimit (rezistente ndaj zjarrit) etj.

IV. Funksionimi i sistemit

Gjatë inspektimit udhëheqësi i Sherbimit të sigurimit ka konstatuar gjendjen ekzistuese të sigurisë në KRU "PRISHTINA" Sh.A.

Gjatë inspektimit të kompleksit të KRU "PRISHTINA" Sh.A. konstatuam me sa vijon:

Rrethojat – Në përgjithësi të gjitha rrethojat janë riparuar për shkak të demtimit të vazhdueshëm nga personat e pandërgjegjshëm si psh. në rezervuarin në Kodren e Trimave, Mirëditë, por prapëseprapë rrethojat nuk plotësojnë standardin e kënaqshëm të sigurisë etj. Të gjitha vërejtjet sipas objekteve të inspektuara detajisht do të shqyrtohen dhe do të jenë pjesë e një Aneks raporti.

Në Fabrikën e Ujit në Badovc -rrethoja përgjatë perimetrit është e demtuar, poashtu edhe porta ngjitur me pjesë të rrethojës është e demtuar. Gjëndje e rënduar paraqitet edhe në lokacione tjera.

Ndriqimi mbrojtës - Mungon ndriqimi përgjatë rrethojave, dhe nuk është e spastruar zona adekuate përgjatë rrethojës sipas standardeve (se paku 6 metra në të dy anet) edhe pse kam rezerva për këtë standard sepse për tu realizuar kërkohet një hapësirë shumë e madhe e tokës.

Në Drejtori ndriqimi i plotëson kriteret minimale.

Poashtu, mungon sistemi elektrik i objektit të drejtorisë, i cili është totalisht i vjetërsuar dhe paraqet rrezik të vazhdueshëm për punëtorët dhe për personat e tjerë që gjenden në objekt.

Portat – Në përgjithësi aplikohet procedura e kontrollit në bazë të cilës rregullohet mënyra e organizimit, kategorizimit dhe funksionimit të akses kontrollit. Portat nuk janë të ndriqura në masë të mjaftueshme, nuk posedojnë aparate alarmi, nuk monitorohen përmes Sistemit të Mbyllur të Kamerave (përveq portës në hymje të objektit dhe hyrjes në drejtori). Portat kanë nevojë për riparime, në mënyrë që të ngritet efikasiteti i tyre .

Gjendja në vendrojet pranë portave është brenda kriteriumit, por ka nevojë për riparime të infrastruktures etj.

Duke përjashtuar Drejtorinë, Fabriken e Ujit në Shkabaj dhe Albanikun të cilët pjesërisht i plotësojnë kushtet e kërkuara në objektet tjera mungon siguri teknik i oborreve dhe objekteve të KRU "Prishtina" Sh.A., (ndriqimi i pamjaftueshëm dhe joadekuat, Sistemi i Mbyllur i Kamerave, sistemet e alarmit (kundër vjedhjes dhe pjesërisht të zjarrit), ndriqimi emergjent në rast të ndaljes së rrymës. Në pikën mbrojtëse tek Penda në Badovc siguri është i organizuar vetëm në ndrrimin e natës dhe atë vetëm me dy punëtor të Sigurimit nga ora 19:00 deri 07:00, mirëpo asnjë automjet nuk është lenë për Sherbimin e Sigurimit.

Kapakët (Dyert) e puseve – Kapakët e puseve në objektin "Kroi" janë objekt i vazhdueshëm i atakimit nga keqbërësit (i njëjti problem shfaqet edhe të regjionet e tjera), Sherbimi i Sigurimit ka ndërmarrë hapat e nevojshëm dhe ka kërkuar nga PK-ja të bëjë patrollime të vazhdueshme në mënyrë që të bëhet mbulimi i tyre pasi që mundësitë e KRU "Prishtina" Sh.A., janë të kufizuara.

Trafiku brenda perimetrit të KRU "Prishtina"

Me kërkesë të vazhdueshme të Sherbimit të Sigurimit është kryer skicimi (vizatimi) i pozicioneve të parkingjeve, kategorizimi dhe sistematizimi i tyre (si dhe ato për menaxhmentin e KRU "Prishtina"). Ketu dolen në sipërfaqe shumë probleme lidhur me atë se ku do të parkohen automjetet duke filluar nga menaxhmenti i lartë dhe kategorit e tjera. Një urdhëresë e nxjerrë pa një analizë të mirëfillt rezultoi të jetë e pa zbatueshme.

Në Drejtori, poashtu, janë instaluar kamera të sigurisë, të cilat mbulojnë parkingjet brenda oborrit të Drejtorisë, mirëpo shumica prej tyre nuk punojnë si rezultat i mungesës së mirëmbajtjes së tyre. Nëpër tërë kampusin e KRUP-it nevojitet të shtohet numri i kamerave sidomos në pjesën përballë objektit të garazhave, të largohen lisat, të shtohet ndriqimi dhe shenjat e trafikut.

Presim që KE-ja do të marrë në konsideratë rekomandimet nga Sherbimi i Sigurimit, do të shfuqizojë këtë urdhëresë dhe do të nxjerrë urdhëresën tejtrë e cila do të jetë e pranueshme nga të gjithë dhe e zbatueshme nga Sherbimi i Sigurimit dhe Zyrtaret e autoparkut.

Kontrolli i hyrje-daljeve (Akces kontrolli) në objektet e KRU "Prishtina" Sh.A.

Kontrollohet dhe mbikëqyret nga Sherbimi i Sigurimit të angazhuar nga KRU „Prishtina” Sh.A.

Është e përcaktuar dhe është aplikuar procedura e kontrollimit të qelsave;

Posedon dhe aplikon procedurat e akces-kontrollit të hyrjes dhe daljes së personelit të KRU "Prishtina" Sh.A. si dhe vizitorëve dhe kontraktorëve të KRU "Prishtina" Sh.A., po ashtu është kërkuar aplikimi, kontrolli i bexhave, aplikimi i kartelave të vizitorëve, ditarizimi i vizitorëve të përhershëm dhe atyre të kohëpaskohshëm si dhe palët afariste, qarkullimi dhe ditarizimi i mallërave duke përfshirë mallërat, pajisjet dhe materialet nga objektet e KRU "Prishtina" Sh.A., ekziston procedura e kontrollit të armëve por nuk praktikohet;

Sipas nevojës aplikohet procedura për sigurim dhe akces/ kontroll të brendshëm në objektet e KRU "Prishtina" Sh.A.;

Aplikohet procedura e kontrollit të daljes së mbeturinave.

Sigurimi teknik (Sistemet e alarmit, Sistemi i Mbyllur i Kamerave, Mbrojtja kundër Zjarrit)

Sistemet e alarmit – KRU "Prishtina" Sh.A. posedon me një sistem modern të alarmit kundër zjarrit.

Mungon alarmi automatik lajmëruar kundër vjedhjes në rast të hyrjes me dhunë në perimetër brenda KRU "Prishtina" Sh.A.;

Aparatet për shuarjen e zjarrit janë në sasi të mjaftueshme, janë vendosur në pikat kritike strategjike dhe të gjitha janë të testuara rregullisht;

Hidrantet janë të vendosur sipas planit dhe janë disajnuar poashtu kutiat për vendosjen e gypave të hidranteve, të gjitha janë në funksion dhe testohen rregullisht;

Mungojnë pajisjet (rrobat) për mbrojtje kundër zjarrit;

Mungojnë kutiat me materiale për ndihmë të parë, në masë të mjaftueshme;

Gjithashtu pikat e rrezikshme dhe materialet e rrezikshme (bombolat e klorit) nuk janë të siguruara, deponuara dhe të kontrolluara sipas rregullave apo standardeve për këto materie (substancë);

Mungon trajnimi i evakuimit në rast emergjent.

Dyert, dritaret dhe të hapurat tjera

Dyert dhe dritaret janë të ndërtuara nga materiali i fortë – korniza dhe qelqi pjesa tjetër. Sa i përket aspektit të sigurisë, këto dyer dhe dritare nuk plotësojnë kënaqshëm kushtet e sigurisë (mungojnë rrjetat e forta metalike apo grilat, drynat nuk janë të përforuara), janë të lehta për tu hapur me dhunë, e poashtu nuk kanë alarm kundër vjedhjes në rast të tentimit të hyrjes me dhunë.

Në katet përdhese, mungon sigurimi mekanik dhe teknik i dyerve dhe dritarëve (pra, nuk kanë grila apo alarme paralajmëruese), dyert nuk janë adekuate.

Nga aspekti i sigurisë muret nuk ofrojnë mundësinë e izolimit nga përhapja e zjarrit të krijuar nga katet tjera.

Gjithashtu rrezik paraqet edhe përdorimi i stabilimenteve të ndryshme të amvisërisë nëpër zyre dhe dhoma, të cilat në mënyrë të paautorizuar janë sjellur në objektet e KRU "PRISHTINA" Sh.A..

Shërbimi i Sigurimit Themelor

Nje prej të arriturave kryesore dhe të suksesshme e cila e vërteton seriozitetin e menaxhmentit aktual është angazhimi i 20 punëtorëve të sigurimit themelor. Procesi i rekrutimit dhe punësimit të 20 punëtorëve të sigurimit themelor është kryer në plotni me ligjet pozitive në Republikën e Kosovës, që është vërtetuar edhe nga kontrolla e Inspektoriatit të Punës. Të gjithë punëtorët janë të licensuar në MPB dhe kanë përvojë të mjaftueshme në sigurimin themelor dhe atë të specializuar. Në KRU "PRISHTINA" Sh.A., Shërbimi i Sigurimit udhëhiqet, organizohet, funksionon dhe realizohet nga shërbimi intern brenda KRU "PRISHTINA" Sh.A., i strukturuar sipas skemes:

Udhëheqësit e Sigurimit	1 person;
Mbikëqyrës i Rojeve	1 person ;
Njesia e sigurimit Porta – Drejtoria Prishtinë	10 persona;
Njesia e sigurimit Kroni	0 persona;
Njesia e sigurimit Albanik.....	0 persona;
Njesia e sigurimit Badovc dhe Penda	4 persona;
Njesia e sigurimit Shkabaj	4 persona;
Njesia e sigurimit – Drejtoria Drenas.....	2 persona;
Gjithsejt:	22 persona;

Gjatë inspektimit të Shërbimit të Sigurimit konstatohet se udhëheqësi i SHS i ka të kryera të gjitha specializimet për menaxher të sigurimit:

Të gjithë punëtorët e sigurimit janë trajnuar dhe i plotësojnë kushtet ligjore për licensim të punëtorëve të sigurimit.

Mungon personeli për të mbuluar tërë hapësirat e domosdoshme për një siguri të nivelit të kënaqshëm. Organizimi, strukturimi dhe funksionimi i shërbimit të sigurimit në masë të madhe përcillet me dokumentacion procedural (raporte nga më të ndryshmet dhe atë raportet ditore, javore, mujore, raportet e incidenteve, ditaret, vlerësimet e punëtorëve etj.) dhe formularët e nevojshëm për dokumentimin dhe kryerjen sa më efikase të punës së sigurimit në KRU "Prishtina" (formularë pranimdorezimi i ndërrimit, evidencës së çelësave, formularët e incidenteve, formularët e deklaratave, formularët e orëve mujor, formularët për vizitorë vendorë dhe të jashtëm, formularët për evidencë të hyrje-daljeve të automjeteve, pajisjeve, të mirave materiale, formularët për kontrollë të automjeteve, formularët për leje-hyrje në objekte të KRU "Prishtina" etj.

Menaxhimi, organizimi, mbikëqyrja dhe interpretimi i detyrave të punës është në pajtim me standardet e sigurimit, të cilat përcaktojnë mënyrën, procedurat, rregullat e sjelljes dhe operimin në detyrë të rojeve të sigurimit mirëpo paraqitet problem të realizohet në praktikë për shkak të mungesës të numrit të mjaftueshëm të punëtorëve të sigurimit.

Kryerja e punëve, aktiviteti, reagimi në rast incidenti të krijuar bëhet në mënyrë hierarkike, sipas procedurës të përcaktuar me parë, pra lajmërohet zingjiri komandues.

V. Konstatimet themelore të Shërbimit të Sigurimit

Në bazë të asaj që u cek si deri më tash konstatohet se KRU "Prishtina" Sh.A.:

KRU "Prishtina" Sh.A., nuk posedon sistem të integruar të sigurimit, sepse kemi të bëjmë me nensisteme të fragmentizuara të sigurimit, të cilat edhe ashtu në formën si janë nuk plotësojnë standardet e kërkuara ligjore. Kërkohet që të ndërtohet Qendra e Kontrollit (si ndërtohet dhe cilat kushte ligjore dhe standarde duhet t'i plotësoj është e rregulluar sipas Udhëzimit Administrativ nr.29/2011 - MPB) e cila mundëson centralizimin e të dhënave dhe mbikëqyrjen e të gjitha lokacioneve nga një vend;

Shërbimet e sigurisë private në Kosovë në masë të madhe janë rregulluar me ligj dhe akte nenligjore të cilat detalisht rregullojnë këtë fushë dhe janë të harmonizuara me standartet Europiane. Mjafton baza

rregullative që përcakton organizimin, funksionimin dhe realizimin e sistemit të sigurimit (pra janë të përcaktuara Politikat dhe Rregullat e Përgjithshme për Roje);
Ekziston përcaktimi i politikave menaxhuese të Sherbimit të sigurimit dhe përcaktimi i procedurave standarde të operimit si dhe organizimi i sistemit në bazë të standardeve të sigurimit;
Mungon sigurimi teknik i objekteve të KRU "PRISHTINA" Sh.A., përveç Drejtorisë, Shkabaj, Badovcit dhe Albanikut ku është rregulluar në masë të madhe. "Sigurimin teknik e përbëjnë: pajisjet teknike (mekanike, elektromagnetike, elektronike, televizive video dhe pajisjet llogaritëse), masat mbrojtëse, pajisjet e sistemit të ndërlidhjes me mbrojtjen trupore, masat e harmonizuara dhe kushtet e aplikimit të mbrojtjes në vendpunishte, përkatësisht vlerës dhe hapësirës që është nën mbrojtje;
Mungon komunikimi i veçantë i puntorëve të sigurimit përmes radiolidhjeve.

Rekomandim masat

Të ngritet niveli i sigurisë në kompleksin e KRU "Prishtina" dhe të përcaktohen nivelet e sigurisë sipas prioriteteve dhe specifikave;

Nga Menaxhmenti i KRU "Prishtina" Sh.A., kërkohet mbështetje në ndërtimin e Qendres së Kontrollit; Të ndërmarrë hapat e nevojshëm për planifikimin dhe ngritjen e nivelit të sigurimit teknik dhe elektronik të objekteve (SMK, sistemi i alarmimit, ndriqimi, rrethojat, kutijat e ndihmës së parë); Të shtohet numri i punëtorëve në sherbim të sigurimit e poashtu të bëhet sistemimi i punëtorëve aktual. Poashtu, të shiqohet mundësia për sigurimin e objekteve, të cilat në mungesë të punëtorëve të sigurimit nuk mbulohen;

Nga sherbimi përkates të bëhet kontrolli i vazhdueshëm i tokëzimit dhe stabilimenteve elektrike në të gjitha objektet;

Të ndërmirren hapat për deponimin adekuat të bombolave të klorit;

Nga sherbimet e specializuara të kërkohet spërkatja kundër gjarpërinjëve e oborrit të objekteve në Badovc;

Është shtuar mbikëqyrja e Pendës në Badovc, e cila është objekt më rëndësi të veçantë;

Të servisohen rregullisht aparatat kunder Zjarrit;

Organizimi i sherbimit të sigurimit të brendshëm do të lejohet pasi që Vendimi i Qeverisë së Kosovës me nr.05/81 , datë 23.03.2016 aprovon Koncept-dokumentin për rregullimin e sherbimeve private të sigurisë, me të cilin nenkuptojnë sherbimet themelore të sigurimit të ofruara nga subjekti afarist, pavarësisht formave të biznesit, i cili ofron sigurim fizik jofitimprurës përsonave dhe pronës në objektet dhe zonat e destinuara vetëm për nevojat e tij të brendshme. Në rastin tonë Pendat dhe Fabrikat e Ujit, bëjnë pjesë në objekte me rëndësi të veçantë (infrastruktura kritike), andaj do të duhet që të fillojnë përgaditjet sepse duhet kohë dhe angazhim. Do të ishte qasje proaktive sikur të fillonim përgaditjet për ndërtimin e Qendres së Kontrollit, sipas Ligjit nr 04/L004 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 29/2011 – MPB për Qendra të Kontrollit.

Në aspektin operativ, ka ngritje të masave taktike preventive të ndërmarra nga punëtorët të sigurimit të sistemuar në Drejtori e veqmas ata në Pendën në Badovc.

Zyra për Mbrojtje dhe Siguri në Punë

Vizita të kryera në teren për vitin 2021: 36 vizita

1. Prej fillimit të muajit Janar është bërë kontrollimi i posedimit të mjeteve themelore për mbrojtje dhe siguri në punë, ku është bërë vizitë në vendpunimet e punëtorëve, në pikat punuese në teren dhe vizitë objekteve në qytet si dhe vizitë Njësi Operative të Kompanisë, ku është munduar që të konstatohet një gjendje faktike e posedimit dhe kushteve të mjeteve të punës.
2. Gjatë muajit qershor, është kryer servisimi dhe kontrolli i aparateve kundër zjarrit, ku zyrtari për mbrojtje në punë ka qenë menaxher i projektit, ku për qëllim të menjimit të krijimit të zjarrit dhe të pengimit të zgjerimit të tij, si dhe me qëllim të shpëtimit të njerëzve dhe të mirave materiale, bëhet kontrolli dhe konstatohet gjendja faktike e tyre për çdo gjashtë (6) muaj.
3. Gjatë vitit 2021 për punëtorët e Sherbimit të Kanalizimit si dhe për disa punëtorë të disa shërbimeve tjera si p.sh., shërbimi i makinerisë dhe shërbimet e mirëmbajtjes së rrjetit, është shpërndar

qumësht për shkak të rrezikut që mund të kenë punëtorët gjatë ndërhyrjeve të sanimeve të gypave dhe rrezikut nga helmimet e mundshme, gjatë vitit 2021 janë shpërndarë 5'470 litra qumësht.

4. Me sasinë e ardhur të mjeteve themelore të punës të sezonit verë – dimër ka vazhduar shpërndarja e tyre ku përfshihen:

- Rroba të punës për sezon verore,
- Rroba të punës për sezon dimërore,
- Qizme pune gome,
- Dorëza lëkure gome,
- Mantel laboratorit etj.

Prej paraqitjes së Pandemisë Sars Cov-2/COVID-19, janë marrë masa mbrojtëse kundër Covid-19, duke furnizuar stafin e KRU "Prishtina" Sh.A., gjatë tërë kohës me maska mbrojtëse, dorëza sterile, dezinfektues për duar, gjithashtu është bërë edhe dezinfektimi i zyrëve në periudha të caktuara në të gjitha NJOU-të si dhe janë bërë kontrole gjatë tërë kohës për respektimin e masave anti Covid.

10. DEPARTAMENTET NËN MENAXHIMIN E DREJTORISË TEKNIKE

Drejtoria Teknike në kuadër të shërbimeve të saj përmbajnë gjashtë departamente: Departamentin e Planifikimit dhe Zhvillimit, Departamentin e Prodhimit, Departamentin e Cilësisë së Ujit, Departamentin e Ujit të pa Faturuar, Departamentin e Furnizimit me Ujë, Departamentin e Ujërave të Ndotura, dhe Divizionin e Auto Parkut.

Drejtoria Teknike gjatë muajve raportues ka arritur të menaxhojë cilësinë e ujit të pijshëm, prodhimin, distribuimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ujit dhe kanalizimit edhe përkundër ballafaqimit me mungesë të burimeve njerëzore, të cilat departamente për një kohë të gjatë nuk janë plotësuar me punëtorë të ri. Me rritjen e kapacitetëve njerëzore do të arrinim formimin e ekipeve monitoruese profesionale, gjë që do të ndikonte dukshëm në arritjen dhe realizimin e planifikimeve, mirëmbajtës preventive, kontrollin dhe monitorimin e humbjeve, mbikëqyrjen e projekteve, kushte me të cilat do të arrihej përmbushja e objektivave dhe rritja e performancës.

Monitorimi i nivelit të liqeneve Batllavë dhe Badovc dhe cilësia e ujit të pijshëm në të gjitha pikat prodhuese është indikator i ndërmarrjes. Fillimi i vitit ka qenë me reshje të mëdha me ç'rast kemi pasur ndikim të dukshëm në ngritjen e nivelit të liqeneve. Ardhjet e furishme në këto raste kane ndikuar në rritjen e turbullirës në liqene dhe në kanalin e lber Lepencit që furnizon ITU Shkabaj dhe Bivolak. Në disa zona reshjet kanë shkaktuar vërshime dhe përmytje të puseve nëntokësore. Me angazhimi i shërbimit të Cilësisë së Ujit dhe Prodhimit është arritur që gjendja të mbahet nën kontroll dhe të ruajmë kualitetin e ujit të pijshëm sipas udhëzimeve dhe normave të OBSH-së. Sipas situatës me nivelin e turbullirës dhe ruajtjes së cilësisë së ujit është menaxhuar me kapacitetet prodhuese, ku gjatë muajit Janar dhe Shkurt kemi pasur reduktime të prodhim për disa ditë në ITU Shkabaj, Badovc, Bivolak dhe pusët nëntokësore. Ndërsa gjatë muajve të verës jemi përballur me temperatura të larta, të cilat kanë ndikuar në rritjen e shpenzimeve dhe është punuar me kapacitete maksimale të prodhimit në mënyrë që furnizimin me ujë të pijshëm të jete stabil në gjithë zonën e shërbimit. Në tremujorin e tretë të vitit, gjatë fundit të muajit Gusht dhe Shtator për shkak të ndryshimeve klimatike (hipotermisë) ka pasur ndryshime në kualitetin e ujit të pa trajtuar në liqenin e Badovcit. Që të mbajmë cilësinë e ujit të pijshëm sipas standardeve jemi obliguar të punojmë me kapacitete të përgjysmuara të prodhimit të ujit të pijshëm nga ITU Badovc. Drejtoria Teknike me Departamentet përkatëse dhe NJOU-të kane qenë të mobilizuara për menaxhimin e situatës në monitorimin e cilësisë së ujit, prodhimit dhe shpërndarjes.

DT me Departamentet dhe NJOU-të kanë analizuar gjëndjen aktuale të humbjeve të ujit të pijshëm dhe për të arritur planin e veprimit në zvogëlimin e humbjeve, kërkohet ngritja e kapaciteteve njerëzore për krijimin e planeve monitoruese, duke shtuar kontrollin mbi shfrytëzimin e paautorizuar të ujit të pijshëm, formimin e ekipeve për skanim të rrjedhjeve dhe skanimeve preventive. Përveç inspektimit, nevojiten edhe investime në sanimin e rrjedhjeve, ndërrimin e rrjetave të ujit dhe instalimin – ndërrimin e ujëmatësve në zonën e shërbimit.

KRU "Prishtina" sh.a., ka aplikuar për grante në IPA, me ç'rast ka marrë aprovimin për fitimin e këtij granti në vlerën 43,400,000.00 euro, prej të cilave 20,000,000.00 euro do të jenë grant nga IPA 2022 dhe 23,400,000.00 euro financim nga KfW për Projektin për Rrjetin e kanalizimit dhe Ujërave atmosferike në Prishtinë. Poashtu në kuadër të këtij Projekti mund të dedikohen fonde shtesë nga KfW, përmes Qeverisë Gjermane në vitin 2022 dhe vitet në vijim.

Sa i përket Programit të IPA III, është bërë vlerësimi i nevojave për projekte për periudhën 2023-2027, të cilat do të jenë bazë për aplikim në IPA III, por edhe në iniciativa të tjera, për të cilat programe janë përgatitur dhe janë bërë të gatshme 16 Projekte për aplikim.

Poashtu jemi në fazën e përpilimit të kontratës për shërbime konsulentë për "Studimin e Fesibilitetit për EËTP" projekt i financuar nga kredia Franceze, për ndërtimin e Impiantit të Ujërave të Ndotura në Prishtinë me zonat përreth.

Vlenë të theksohet se Menaxhmenti i lartë ka arritur që të sjellë donacion nga Qeveria e Katarit për qëndrueshmërinë e furnizimit me ujë duke investuar në ndërtimin e rrjetit të ujit dhe infrastrukturës përcjellëse për qytetin e Shtimes si dhe fshatrave për rreth.

Në kuadër të bashkëpunimit me Qytetin e Bursës, Turqi, kemi bërë aplikimin për grante nga Bursa, respektivisht për 10000-15000 ujëmatës, një cisternë dhe një bager, për të cilat jemi në pritje të aprovimit.

Planifikimet dhe sugjerimet ne Drejtorin Teknike

Ne kuadër të DPZH (Departamentit të Planifikimit dhe Zhvillimit), planifikimet rrjedhin më shumë nga plani i biznesit dhe si tillë është në implementim e sipër, aktivitete tjera planifikuese shtrihen edhe në bashkëpunimet me Komuna dhe donatorë, ku DPZH harton projektet zbatuese për implementim për Ministri, Komuna dhe Donatorë, sigurisht prioritet i kushtohet aktiviteteve në kuadër të departamentit, mbikëqyrjen, e projekteve dhe hartimin e specifikave teknike. Po ashtu përveç aktiviteteve bazike, në kuadër të DPZH planifikohen të hartohen dhe caktohen DMA Zonat, kufizimi i tyre, po ashtu edhe Plani i Sigurisë së ujit. Në kuadër të DPZH ekziston edhe shërbimi i GIS të cilët planifikojnë implementimin e sistemit MIA – EDAMS për menaxhimin e integruar të aseteve, si dhe asistencë për shërbimet tjera Departamenti i Prodhimit – Trajtimit, planifikon që të mbajë nivelin e trajtimit të ujit, duke pasur kujdes të veçantë në shfrytëzimin e burimeve të ujit, sidomos Badovci dhe pusët nëntokësore pasi që mungesa e reshjeve të borës gjatë sezonit të dimrit është sinjal që mund të ketë probleme, edhe pse pritsh mërit janë që muajt Prill dhe Maj të sjellin reshje. Misioni i departamentit është plotësimi i kërkesave për ujë për të gjithë konsumatorët, mirëpo infrastruktura e cunguar në shpërndarje shpesh here paraqet problemet e veta.

Departamenti për Cilësi të Ujit dhe Burime, do të vazhdoj me planifikimet për mostrime dhe monitorim të rreptë të cilësisë së ujit të pijshëm, në bashkëpunim edhe me pjesën e njësisë për mbrojtje të burimeve ujore. Në fillim vit janë vendosur shenjat paralajmëruese për zonat mbrojtëse, ani pse për fat të keq kishte vandalizma që dëmtuan. Departamenti për cilësinë e ujit planifikohet që të transferohet në objektin e ITU në Shkabaj, aty ku edhe infrastruktura është më e mirë dhe janë pajisje shtesë që planifikohen të futen në punë.

Departamenti për reduktimi në Humbjeve të ujit, gjatë këtij tre muajori ka pasur më pak aktivitete si shkak i kushteve klimatike, janë përqendruar më shumë në harmonizimin e kërkesave me DPZH për planifikimin e DMA Zonave, inspektime me lexues, mirëpo veprime konkrete nuk ka pasur shumë. Gjatë pjesës vijuese pritet të intensifikohen aksionet në terren me ekipe shtesë për identifikimin e kyçjeve ilegale dhe monitorimin e DMA ekzistuese.

Departamenti i Mirëmbajtjes së ujit, planifikon të vazhdoj me mirëmbajtje rutine, për fat të keq ende reaktive, ani pse planifikimet janë që të lëvizet në mirëmbajtje proaktive. Planifikohet që të gjitha sanimet dhe rastet e lajmëruara të sanohen brenda ditës, duke i kushtuar rëndësi shfrytëzimit të materialeve, porosisë me kohë në procedura të prokurimit, po ashtu planifikohet që të shtohet numri i ndërrimit të ujëmatësve si pikë kyçe për reduktimin e humbjeve të ujit.

Departamenti për operim dhe mirëmbajtjen e sistemeve të kanalizimeve, do të vazhdoj me mirëmbajtje rutinore, duke përfshirë pastrimet e pusëtave, asistencë nëpër Njësi Operative, identifikimi i problemeve në rrjet, asistencë konsulencës Gjermane për hartimin dhe finalizimin e fizibilitetit dhe master planit.

Sfidat për të arritur planifikimet

Në drejtorinë teknike siç është cekur edhe më lartë mungesa e stafit dhe mosha e shtyrë e tyre paraqet problem të madh, pastaj mungesa e auto mekanizmit, amortizimi i skajshëm i mekanizmit ekzistues, mungesa e stafit profesional sidomos në departamentin për reduktim të humbjeve është sfida më e madhe sa i përket resurseve njerëzore, angazhimi nuk do të mungojë me resurset ekzistuese që të arrihen të paktën caqet kryesore të planifikuara, por sfida mbeten humbjet, aty ku ka nevojë të rritet numri i inspektorëve. Ndërlidhja me drejtori komerciale pa shmangshëm shkakton probleme, mirëpo e njëjta ankohet për mungesa stafi po ashtu. Rritja e çmimeve në tregun global ka ndikuar shumë në rritje të çmimeve të pjesëve rezervë, fazoneri, tubacione, por ka ndikuar jashtëzakonisht shumë edhe në rritje të kemikateve bazë për trajtim të ujit.

Rekomandime – Kritika për menaxhmentin

Te jepet mundësia sa më shpejtë për shpallje konkursesh për staf të ri, ndërsa për pjesët tjera menaxhmenti është bashkëpunues dhe në përkrahje të departamenteve, përveç NJAB që si njësi shpesh here me rekomandimet e tyre na vendosin para situatave të pa kuptimta dhe shpesh here ndikojnë edhe në sjelljet kolegjiale në mes stafit.

10.1 Departamenti i Prodhimit

Në Departamentin e Prodhimit kemi vazhduar me realizimin e planifikimit të prodhimit për tremujorin Janar-Mars 2022. Prodhimi mujor është afërsisht me planifikimin mujor. Uji primar në Liqejt akumulues ka arrit të këtë një kualitet më të mirë ashtu që kemi mundësi që të punojmë me kapacitete optimale. Në FPU SHKABAJ jemi ballafaquar me ngecje të herëpasëherëshme për shkak të ngritjes së turbiditetit në ujin e kanalit, me kohë dhe me preventivë është evituar edhe ky problem.

Edhe nëpër Njësi Operative në Komuna tjera muajin e kaluar kemi një prodhimtari bazuar në kapacitete optimale dhe përshtatur nevojave të kërkesës së prodhimit të ujit të pijes. Zona e furnizimit në Lipjan dhe rrethinë, ka një ndieshmëri të mungesës së ujit pasi që kemi edhe rënjen e nivelit të ujërave nëntoksore si pasojë e thatësirës që po mbizotron kohë të gjatë

Tani për tani kemi një situatë të volitshme hidrike në liqein e Batllavës ka një muaj që është në pikën maksimale të kapërderdhjes. Më pak e volitshme është situata me liqenin e Badovcit ne mungese të rreshjeve gjatë sezonit të dimrit. Po mbretëron thatësi e madhe dhe uji duhet të shfrytëzohet me kujdesë ashtu që edhe për muajt në vijim të kemi sasi premtuese.

Tabela nr. 19: Niveli i Liqejeve

Niveli i Liqenit	BATLLAVA	BADOVCI
Data 18.10.2021	635 max, 631.58 m (-3.42m)	649.85 m max , 644.60m (-5.25m)
Data 28.12.2021	635 max, 631.47 m (-3.53m)	649.85 m max , 643.80m (-6.05m)

Tabela nr. 20: Prodhimi për vitin 2021

2021	TOTALI UJIT TË DISTRIB. ~m3/muaj~	TOTALI UJIT TË DISTRIB. ~l/s	E PLANIFIKUAR ~m3/muaj~	Përqindja e realizuar
Janar	4,233,040	1,580	4,572,029	92.59%
Shkurt	4,243,653	1,694	4,129,574	102.76%
Mars	4,665,702	1,742	4,572,029	102.05%
Prill	4,621,775	1,783	4,424,544	104.46%
Maj	4,750,870	1,774	4,572,029	103.91%
Qershor	4,690,407	1,810	4,424,544	106.01%
Korrik	4,950,866	1,848	4,572,029	108.29%
Gusht	4,748,343	1,773	4,572,029	103.86%
Shtator	4,575,513	1,765	4,424,544	103.41%
Tetor	4,700,045	1,755	4,572,029	102.80%
Nëntor	4,434,521	1,711	4,424,544	100.23%
Dhjetor	4,560,313	1,703	4,572,029	99.74%
Totali	55,175,048	1,745	53,831,952	102.51%

Punët kanë vazhduar me ritmin e zakonshëm sipas planifikimit, qëllimi i trajtimit sa më cilësor të ujit të pijes ka vazhduar pa ngecje të theksuara, në të gjitha objektet për përpunimin e ujit të pijes.

Tabela nr. 21: Paraqitja në formë tabelore e intervenimeve për shërbime

Punët dhe aktivitetet 2021		
Shërbimi	Numri i intervenimeve	Aktivitetet më të rëndësishme mujore
Shërbimi i Makinerisë	127	Mirëmbajtja makinerisë e planifikuar, preventive dhe rastet emergjente të paparashikuara
Shërbimi i Elektrikës	164	Mirëmbajtja elektrike e planifikuar, preventive dhe rastet emergjente të paparashikuara
Shërbimi i sistemeve dozuuese	28	Mirëmbajtja për sistemet dozuuese e planifikuar, preventive dhe rastet emergjente të paparashikuara

Ballafaqimi me mungesa të energjisë elektrike në disa nga objektet prodhuese nën arsyetimin e përfundimit të punëve të planifikuara të KEDS dhe ndërprerje pa paralajmërim të energjisë elektrike në raste të shumta kanë shkaktuar ndërprerje të tërësishme të stabilimenteve prodhuese dhe

përpunuese të ujit. Përkundër kësaj kohët e fundit nuk kemi ballafaqime të shpeshta me mungesë të energjisë për objektet e KUR Prishtina, sidomos objektet vitale të prodhimit të ujit të pijes kanë pasur furnizim të pandërprerë me energji elektrike.

Për saktësinë e matjes së ujit të prodhuar në objekte prodhuese, planifikohet të ndërrohen matësit ekzistues për shkak të amortizimit (vjetërsisë).

10.2 Departamenti i Cilësia e Ujit dhe Burimet

Departamenti për Kontrollin e Kualitetit të ujit duke u bazuar në Standardet cilësore, aplikative (U.A.16/2012) dhe ato evropiane (Udhëzimi –Direktiva 98/83/EC) mbi kualitetin e ujit për përdorim nga njerëzit (me parë direktiva 80/778/EEC). Kjo direktivë përcakton dallimet në mes të parametrave mikrobiologjik dhe atyre fiziko- kimik. Aplikimi i standardeve është në interes të gjithë konsumatorët e Prishtinës, Shtimes, F. Kosovë, Obiliqit, Lipjanit, Podujevës, Drenasit dhe Graçanicës. Departamenti i Kualitetit të Ujit me planin e tij të monitorimit brendshëm të kualitetit të ujit ka në procedurë pikë së pari mbledhjen marrjen e mostrave të ujit të përpunuar nga rrjeti i ujësjellësit, aeratorëve, liqejeve, puseve dhe lumenjve.

Shërbimi i Kualitetit të Ujit

Laboratorët shfrytëzojnë metoda standarde për parametrat të cilat janë të aprovuara nga BE, sipas procedurës të cilat janë dhënë me Direktivën 98 (93) EC. Mjetet dhe aparatet janë të sofistikuar kurse reagjentët janë të standardizuar dhe me afat. Aplikohet Standardi 17025:2005 ku janë kërkesat që laboratorët e testimit duhet të plotësojnë nëse ato dëshirojnë të demonstrojnë që ato operojnë një sistem menaxhimi.

Aktivitetet - përshkrimi i punëve të kryera brenda vitit raportues;

Sipas planit për monitorimin e brendshëm të kualitetit të ujit në të gjitha zonat e shërbimit të KRU "Prishtina" sh.a, në aplikim të monitorimit të shpejtë bazik dhe vijues kemi përcjelle kualitetin e ujit të pijshëm në çdo pikë mostrimi.

Cilësia e ujit është e kontrolluar dhe testuar me analiza fiziko-kimike dhe bakteriologjike sipas parametrave të cilët janë në Listën A dhe C në Udhëzimin Administrativ nr.16/2012 për cilësinë e ujit për konsum, funksionalizimi dhe startimi i punës me metoda standarde dhe procedura të Akreditimit. Përgatitja e specifikacioneve teknike si dhe vlerësimi i ofertave për projektet e planifikuara në Plan Prokurimit për furnizim me Klor të gaztë dhe hipoklorit natriumi, furnizim me Sulfat alumini, Furnizim me kemikate (Sulfat Bakri, Ferik Sulfat, Permanganat Kaliumi, Poli elektrolit, Acid Klorhidrik, Gëlqere e shuar dhe Dioksid klori), furnizimi me reagjentë për kontrollë të cilësisë së ujit, Shërbim për DDD, Shërbim për Kontrolle sanitare kryerje të shërbimeve.

Monitorimi dhe analizimi i kualitetit të ujit sipërfaqësor, lumenjve, liqejtë, pusët nëntokësore, rezervuarat e ujit ku deponohet ujë në objekte prodhuese dhe distribuese, përcaktimi i dozimit të kemi kateve dozuese Klorit gaztë, Sulfatit Aluminit, Permanganatit të Kaliumit, Poli elektroliteve;

Është bërë plotësim-ndryshimi në Manualin e ISO Standardi 17025:2017 në menaxhimin e Sistemit të Manualit të Cilësisë ose ndryshe quhet Sistemi i Menaxhimit të Laboratorit për Akreditim.

Cilësia e ujit është e kontrolluar dhe testuar me analiza fiziko-kimike dhe bakteriologjike sipas parametrave të cilët janë në Listën A dhe C në Udhëzimin Administrativ nr.16/2012 për cilësinë e ujit për konsum nga njeriu.

Departamenti i Cilësisë së Ujit dhe burimeve të ujit përveç monitorimit bazik është përballë me shumë aktivitete tjera shtesë si pasojë e të reshurave që kanë shkaktuar turbullira të mëdha mbi 300 NTU në kanalin Ibër-Lepenc dhe në Liqenin e Badovcit 150 NTU dhe kjo gjendje na ka shfaq telashe në trajtim të ujit duke ndërprerë prodhimin e ujit në FPU në Bivolak, Shkabaj dhe Badovc. Në tremujorin tetor -dhjetor kemi pas një gjendje konstante të kualitetit të ujit sa i përket cilësisë së ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor si dhe në ujën e pijshëm. Gjithashtu edhe cilësia e ujit sipërfaqësor të dy liqejeve në bazë të analizave të bëra në nivele dhe distanca të ndryshme në liqe kanë dhanë rezultate të kënaqshme për kualitet të lartë të ujit.

Pengesa dhe sfida gjatë vitit 2021 situata me pandemi, kontaminimi i ujit pijshëm me ujërat zeza në lagjen Vetërrikut, në fshatin Miradi e ultë si dhe në fshatin Henc, ku qytetarë të papërgjegjshëm kanë

fut në sistemin e ujit pijshëm, ujërat e puseve individuale të kontaminuar, duke na shkaktuar shumë probleme dhe telashe në evitim të tyre.

Janar-dhjetor 2021 kanë qenë 10884 mostra total fiziko-kimike dhe bakteriologjike, i cili plan është realizuar për 44 mostra më shumë se të planifikuara ose 100.41% të realizuara. Të planifikuara kanë qenë 10840 mostra, janë realizuar mostra më shumë. Të planifikuara për dymbëdhjetë mujorin mostra të dështuara ose keq (jashtë standardeve) kanë qenë 72 mostra.

Tabela nr. 22: Paraqitja tabelore e rezultateve të testeve të ujit të papërpunuar dhe të pijshëm në aspektin fiziko-kimik dhe bakteriologjik

Numri i testimeve të kryera:	1,683 Mostra fiziko-kimike
	1,683 Mostra bakteriologjike
	3,366 Total mostra fiziko-kimike dhe bakteriologjike
Rezultatet e fituara nga laboratorit:	2,814 Mostra ujë të pijshëm(përpunuar)
	552 Mostra ujë jo i pijshëm(papërpunuar).
	17 (shtatëmbëdhjetë) mostra jashtë standardit
Rezultatet e raportuara	Në bazë të analizave kimike dhe bakteriologjike të ujit të trajtuar janë testuar 2814 mostra të ujit të pijshëm ku prej tyre mirë janë 2797 ose 99.40% i përgjigjen U.A Nr 16/2012 për cilësinë e ujit për konsum nga njeriu, kurse nuk i përgjigjen 17 (shtatëmbëdhjetë) mostra ose 0.60% janë jashtë standardit për ujëra të pijshëm Rezultatet e 552 mostrave të kryera për ujëra të papërpunuar i përgjigjen Standardeve për kualitet të ujit të papërpunuar!
Gjendja e pajisjeve:	E rregullte dhe funksionale!
Infrastruktura:	Në rregull!

Shërbimi i Monitorimit Operacional dhe mbrojtja e burimeve

Departamenti i Cilësisë së Ujit dhe burimeve të ujit si prioritet ka kontrollin e cilësisë së ujit të pijshëm sipas Udhëzimit Administrativ rr.16/2012 dhe mbrojtjen e resurseve ujore që shfrytëzohen për ujë pijshëm sipas Udhëzimit Administrativ nr.15/2017 për kriteret për përcaktimin e zonave të mbrojtura sanitare.

Është realizuar projekti për vendosjen e shënjave sinjalizuese për zonat mbrojtëse të ujërat sipërfaqor dhe nëntokësor sipas kriterit të kërkuar në Udhëzim Administrativ në fuqi! Inspektim për mbrojtje të burimeve në teren është bërë në tremujorin e fundit dhe gjendja ekzistuese e stabilimenteve dhe rezervuarve të ujit pijshëm në FPU Badovc, FPU Shkabaj, SP Kroni, Vragoli, NJOU Lipjan, NJOU Shtime dhe NJOU Drenas si dhe te Stacioni i pompimit "Kroni" në Kuzmin dhe te Stacioni i pompimit në Vragoli. Inspektim në Drenas i fabrikën për përpunimin e ujit, rezervuarët, filtrat, sistemin e klorimit dhe galerinë e gypave. Inspektimi në Bivolak te Stacioni për përpunim të ujit, galerinë e gypave, sistemi i klorimit dhe të flokulatori.

Menaxhimi i kontratës me Hortikulturën për pastrimin dhe grumbullimin e mbeturinave inerte përgjatë sipërfaqes së Liqenit të Badovcit. Kompania Rajonale Ujësjetësi "Prishtina" sh.a ka kërkuar nga Agjensioni i Menaxhimit të Emergjencave për aktivitetet e ardhshme të këtij njoftim. Edhe gjatë vitit 2021 kemi pasur aktivitete për pastrimin e Liqenit të Badovcit duke pasur parasysh gjendjen pandemike ju kemi ikur organizimeve me numër të mëdha.

Verifikimi ose Inspektimi në teren në bashkëpunim me inspektoret e kontrollës së ujit pijshëm për të qartësuar dyshimet se a po keqpërdoret ujë i pijshëm nga qytetaret, ankesat nga konsumatorët për kualitet të ujit.

Aktivitet tjetër gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2021 ka qenë projekti për vendosjen e shenjave sinjalizuese për zonat mbrojtëse të ujerat sipërfaqor dhe nëntokësor sipas kriterit të kërkuar në Udhëzim Administrativ Nr. 15/2017.

10.3 Departamenti Furnizim me Ujë

Departamenti i mirëmbajtjes me shërbimet e veta, bënë mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjeve të KRU "PRISHTINA" sh.a., përgjigjet për gatishmërinë e tyre teknike dhe funksionale dhe bënë skanimin në çdo kohë dhe në çdo vend në zonën e shërbimeve të gjitha defektet , avarit dhe pengesave tjera që paraqiten sa më shpejtë dhe sa më me pak shpenzime duke u mbështetur në radhë të parë në mjetet e KRU-së dhe materialin të cilën e ka në dispozicion.

Ne kuadër të këtij Departamenti Operojnë këto shërbime:

- Shërbimi i Rrjetit të Ujit
- Shërbimi i Ujëmatësve
- Shërbimi i Dispeçerisë

Shërbimi operimi dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujit

Gjatë periudhës raportuese janar-dhjetor të vitit 2021 në Departamentin e Mirëmbajtjes janë bërë shume intervenime neper te gjitha shërbimet, te cilat do t'i paraqesim ne tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 23: Paraqitja në formë tabelore e intervenimeve për shërbime

VII/2021	TM4	
	Paraqitja e rasteve	Rastet e kryera
Rrjeti i furnizim.	684	673
Shërbimi i ujëmatësve	142	142

Shërbimi i rrjetit-mirëmbajtja (Emergjente) në periudhën raportuese ka intervenua në 673 raste të ndryshme kryesisht në rrjeta me profile të vogla.

Ky shërbim është duke u ballafaquar me problemin e mungesës së stafit sidomos për pjesën periferike të Prishtinës dhe F. Kosovës, ku vetëm me një ekip operohet në këtë pjesë e që është e pamundur të kryhen të gjitha rastet e defekteve me kohë.

Problemi i mirëmbajtjes ka të bëjë edhe me mungesën e mekanizimit respektivisht me ekskavator dhe manipulues të makinave

Departamenti i Mirëmbajtjes, ka nevojë të freskohet me punëtorë të ri, meqë një pjesë është e shtyre në moshe si dhe në gjendje të vështirë shëndetësore

Shërbimi i ujëmatësve dhe kalibrimi

Është intervenuar në riparimin e ujëmatësve të ndryshëm, gjithsej 142 raste, në ndërrimin e ujëmatësve dhe 10 raste të intervenimeve të ndryshme, në ndërrimin e valvuleve para dhe pas ujëmatësve, pastrimin apo edhe ndërrimin e xhamave të ujëmatësit. Edhe pse me shumë vështirësi dhe pengesave në pajisjet e laboratorit për kalibrimi, ky shërbim ka ofruar mundësitë e kalibrimit të Ujëmatësve për kërkesa të konsumatorëve. Në vazhdim në mënyrë tabelare është paraqitë numri i ujëmatësve të ndërruar sipas profileve dhe kategorive të konsumatorëve.

Shërbimi i dispeçerëve

Ky shërbim është në dispozicion 24 h ku bënë , harmonizimin e punëve për funksionimin normal dhe kontinual të tërë sistemit në stacionet e pompimit, FPU dhe në puse të KRU-së.

Për këtë shërbim ka nevojë të funksionalizimet sistemi i SKAD-ës për menaxhim dhe furnizim me të mirë të ujit të pijes për konsumator.

10.4 Departamenti i Ujërave të Ndotura

Departamenti është organizimi dhe funksionimi i tij për mirëmbajtjen e sistemit të kanalizimit dhe trajtimin e ujerave të zeza duke u bazuar dhe plotësuar standardet sipas udhëzimit administrativ.

Departamenti i Mirëmbajtjes dhe Trajtimin e Ujërave të Ndotura është i përbërë nga:

Shërbimit i Mirëmbajtjes të Rrjetit të Kanalizimit, ku bënë mirëmbajtjen e sistemeve të kanalizimit në KRU "PRISHTINA" sh.a., në të gjithë zonën e shërbimit që përfshin 8 komuna, me gjatësi të rrjetit të kanalizimit 1093km.

Momentalisht janë dy Implantet të Trajtimit të Ujërave të Ndotura në funksion.

Implanti i trajtimit të ujërave të ndotura në Halilaq nën zonën kadastrale F. Kosovës

Implanti i trajtimit të ujërave të ndotura në Mramor – Badoc nën zonën kadastrale Prishtinë

Trajtimi i ujërave të zeza bëhet duke u bazuar në udhëzimin administrativ MMPH – Nr.30/2014 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese të shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujqor. Ky udhëzim përcakton kriteret e përgjithshme për shkarkimin e ujërave të ndotura, cakton parametrat fiziko-kimike dhe atyre bakteriologjik.

Tabela nr. 24: Sasitë në m³ për trajtimin e ujërave të ndotura në dy implantet

Viti 2021	Implanti Halilaq Vëllimi i trajtuar m ³	në	Implanti Mramor Vëllimi i trajtuar m ³	në
Janar		3,685		18,500
Shkurt		3,931		16,500
Mars		5,703		15,250
Prill		5,607		11,250
Maj		478		11,750
Qershor		5,303		13,500
Korrik		4,535		16,750
Gusht		2,474		12,000
Shtator		2,457		13,000
Tetor		3,299		21,750
Nëntor		3,870		25,000
Dhjetor		4,158		25,500
Totali		45,500		200,750

Gjatë vitit 2021 – TM4 kemi pas gjithsejtë 1021 intervenime-de bllokime të kanalizimit, pastrim të pusetave 102 peseta dhe vendosje të kapakëve të pusetave b/m, 51/8 kapak në gjithë zonën e shërbimit të KRUP.

Tabela nr. 25: Krahasim i rasteve të de bllokimit të kanalizimit me vitin paraprak:

Viti	TM4
2020	881
2021	1021

Sipas rregullores nr.10/2019 për standardet minimale të shërbimeve të ujit në Kosovë: i tërë rrjeti i kanalizimit duhet të pastrohet së paku një herë në pesë (5) vjet, dhe të gjitha pesetat e kanalizimit duhet të inspektohen së paku një herë në dy (2) vjet dhe duhet të bëhet pastrimi i tyre varësisht prej nevojës.

Tabela nr. 26: Planifikimi tre mujor për pastrim të rrjetit të kanalizimit në metra gjatësi

Viti	TM4	TM4
Planifikimi tre mujor për pastrim të rrjetit të kanalizimit në metra gjatësi		Planifikimi tre mujor për pastrim të pesetave
2020	60000	202070
2021	58250	2021102

Pengesat dhe sfidat gjatë punës: Për de bllokimin dhe pastrimin e numrit të madhe të rasteve të paraqitura dhe arritjen e planifikimeve kemi vështirësi për shkak se në departament kemi mungesë të punëtorëve fizik.

10.5 Departamenti i Ujit të Pa faturuar – UPF

Departamenti i ujit të pa faturuar funksionon me shërbime si më poshtë:

- Shërbimi për detektimin e rrjedhjeve
- Shërbimi i Kontrollit dhe Lidhjeve

Bazuar ne sasinë e prodhimit dhe faturimit fillimisht ju njoftojmë me shkallen e humbjeve të ujit për periudhën Janar - Dhjetor për zonën e shërbimit në KRUP është 57.29%

Faktorët që ndikojnë në humbjet e larta të ujit:

Faturimet minimale mujore ndikojnë në mos rritjen e shkallës së faturimi, Keqpërdorimet e ujit, rrjedhja në gypa, mosfunksionimi i ujëmatësëve, mos lejimi i qasjes në ujëmatës, Leximet janë të vështirësuar edhe për shkaqe të situatës aktuale (Pandemisë) në të cilën po kalojmë deri tani e që është edhe një problem shtesë i cili po ndikon negativisht tek lexuesit karshi qasjes tek konsumatori,

Raportimi nga lexuesit për numër të madhe të ujëmatësëve që vazhdojnë të jenë jashtë funksionit, Faturimi vetëm me tarifë fikse për konsumatorët që nuk kanë të instaluar ujëmatës individual sipas rregullores së ARRU-së vazhdon të jetë një sfidë në vetë dhe në dëme të kompanisë. Konsumatorët hezitojnë të vendosin ujëmatës dhe vështirësojnë qasjen e lexuesve dhe inspektorëve në shumë raste, Amortizimi i rrjetave shpërndarëse, rritja e kohës nga raportimi deri në riparimin e rrjedhjes, mungesë e personelit të operativës është një faktor i lartë që ndikon në rritjen drejtpërdrejtë të humbjeve fizike të ujit.

Shërbimi për detektimin e rrjedhjeve

Duhet cekur se shërbimi për detektimin e rrjedhjeve të Ujit ka mungesë të stafit punës pasi përbehet vetëm nga dy inspektorë (numër jashtëzakonisht i vogël). Edhe përkundër kësaj Shërbimi ka funksionuar mirë duke bërë kontrole aktive në rrjetat e ujësjellësit në tërë zonën e shërbimit dhe njëkohësisht ka mbështetur ekipet e shërbimeve tjera si: Mirëmbajtja e Rrjetit, Makinaria, Elektro, Shërbimi i Ujerave të ndotura etj. Duhet cekur se Shërbimi ka ndihmuar - asistuar edhe të gjitha NJOU, në total 378 raste të detektimit.

Detektimin e Rrjedhjeve, lokacioni i rrjedhjeve të dukshme të raportuara nga personeli i ujësjellësit, qytetarët dhe institucionet e tjera.

Punë me aparaturë për gjetjen e sakte të infrastrukturës nëntokësore siç janë: tubacionet, armaturat, kapakët metalik, kablllo nëntokësore (KEDS, IPKO, PTK) të mos dëmtohen infrastruktura e tyre gjatë intervenimit të operativës.

Kontrollimi i ujëmatësëve zonal dy herë në muaj në zonën e shërbimit dhe analiza e tyre.

Kontrollimi dhe detektimi i rrjedhjeve të padukshme (nëntokësore).

Tabela nr. 27: Aktivitetet e Shërbimit për detektimin e Rrjedhjeve

Viti 2021	TM4
Detektimi i rrjedhjeve	378
Detektim të infrastrukturave	34
Kontrolli DMA	25
Kontrolli aktiviteti të rrjetit (km)	35

Leximi i rregullt i ujëmatësëve zonal

Vazhdon mos leximi në kohe reale për zonat DMA si shkak i skadimit të kohës së mirëmbajtjes së data loggerave të prodhuesit përkatës HWM (Halma Water Management), leximi bëhet në menyre manuale në teren.

Instalimi i softueri i kompanisë Gjermane SEBA pasi edhe produkti është i se njëjtës kompani nga cila behet edhe transportimi i te dhënave çdo 24 ore për pulset e rrjedhjes dhe presionit çdo 10 minuta.

Zonat e reja matëse (DMA) janë ndërtuar ne këto NJOU:

- Ne zonën e rrjetit te Prishtinës janë vendosur 3 UZ(Ujemtës Zonal)
- Ne zone e rrjetit shpërndarës ne Drenas janë te vendosur 2 UZ.
- Ne zone e rrjetit shpërndarës ne Lipjan janë vendosur 3 UZ.
- Ne zonën e rrjetit shpërndarës ne Podujeve janë vendosur 3 UZ.

Shërbimi i detektimit dhe rrjedhjes është shumë i vogël në personel kur dihet shpërndarja e rrjetit te ujësjellësit ne tere zonën e shërbimit. Kërkesat nga Departamenti janë qe te rritet ky shërbim me personel përkatës si dhe te trajnohet ne fushën e humbjeve te ujit sipas metodologjive dhe teknologjive te reja te cilat sot janë tepër te avancuara.

Shërbimi i Kontrollit dhe Lidhjeve

Njesia-Task Forca-Shkycqjet

Tabela nr. 28:Shërbimi i inspektimit dhe shkycqjes

Aktivitetet	TM4
Rredhjet	0
Ispektimet	450
Vizitat	2819
Shkycqjet	6
Rikycqjet	5
Nr. i pagesave	587
Shuma e pagesave	€ 156,272.00
Kycqjet i legale	13
Çkycqjet ilegale	19
Rikycqja pas aplikimit	4
Nr. i riprogamomeve	33
Konsumator të ri	26

Tabela nr. 29: Njësia Kontrolli i Faturimit dhe legalizimet individuale

Aktivitetet	TM4
Vend.te Billobave	437
Ankesa te Pranuar	1076
Ankesa Te Trajtuara	944
Inspekti te lexuesi	122
Numri Kons.te vizituar	1131
Te ndryshme sipas kerkesave	0
Lendet	61
Lidhje te Reja	184
Kushte Teknike	96

10.6 Departamenti Planifikimit dhe Zhvillimit

Qëllimi i Departamentit është organizimi dhe funksionimi i saj në planifikimin dhe zhvillimin e projekteve si dhe zhvillimin dhe integrimin e të dhënave në data bazën e GIS duke u bazuar dhe plotësuar standardet sipas ligjeve dhe udhëzimeve administrative në fuqi.

Përveç operimeve ditore teknike merret edhe me analizë analitike të gjithë treguesve teknik dhe financiar të përcaktuar nga Autoriteti Rregullator i Ujit.

Zyra e Planifikimit dhe zhvillimit në vete përmban dy shërbime:

- Shërbimi i projektimit dhe planifikimit
- Shërbimin e Gis-it

Shërbimin i projektimit dhe planifikimit

Shërbimi i projektimit dhe planifikimit bënë analizimin dhe projektimin e projekteve të infrastrukturës dhe planeve zhvillimore në KRUP :

- Analizimin dhe hartimi i projekteve në kuadër të KRU"Prishtina"
- Analizimi i kërkesave për kushte teknike, kërkesave për lidhje uji, dhe përgatitja e pëlqimeve.
- Inspektime dhe matjet e nevojshme për lëshimin e pëlqimeve për lidhje në sistem.
- Vlerësimin, mbikëqyrjen e projekteve të parapara në planin e prokurimit për vitin 2021.
- Projektit menaxhimi i integruar i aseteve në KRU-Prishtina
- Analizimi dhe përpilimi i zgjidhjeve teknike në fazën e kërkesave për kushte teknike
- Analizimi dhe përpilimi i zgjidhjes teknike në fazën e kërkesave për kyçje

Hartimi i projekteve të parapara në planin e prokurimit:

Mbledhja e informacioneve nga terreni, për hartimin e Projekteve dhe specifikacioneve teknik për Rehabilitimin e Rrjetave ekzistuese që ndikojnë në përmirësimin e furnizimit me ujë dhe zvogëlimin e humbjeve në zonën e shërbimit.

Analizimin dhe incizimin e terrenit për hartimin e projektit të rrjetit të ujësjellësve dhe kanalizimeve.

Analizimi i kërkesave për zhvendosjen e gypit të ujësjellësit, përpilimi i zgjidhjes dhe kushteve teknike për pëlqime dhe në raste përpilimi i koncept projektit.

Analizimi dhe inspektimi i gjendjes ekzistuese për përpilimin e projektit për Rehabilitimet e objekteve në KRUP (rehabilitimi ndërtimor, makinerike dhe elektrik i objekteve prodhueses)

Përpilimi i projekteve dhe specifikacionit teknik për rehabilitim të rrjetave të ujit dhe kanalizimit në bashkëfinancim me komunat në zonën e shërbimit.

Përgatitja e para masës dhe specifikave teknike për projektin e instalimit të ujëmatësve dhe ujëmatësve zonal në zonën e shërbimit.

Aplikimi dhe shqyrtimi i lëndëve

Tabela nr. 30: Lista e lëndëve periudha Janar – Dhjetor 2021

Nr.	Viti 2021	Të pranuar	Të shqyrtuara	Në shqyrtim
1	Pëlqime për kyçje kolektive dhe individuale	59	30	29
2	Kushte Teknike	107	92	20
3	Përgjigje në kërkesa- Informacione për infrastrukturë	12	11	1
4	Legalizimi i ujëmatësve kolektive	15	4	11

